

Të nderuar anëtarë të Asamblesë,

Me anë të kësaj letre, paraqes kandidaturën time për të shërbyer **Anëtare e Këshillit të Drejtimit** të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Si audituese ligjore, licensuar në janar 2015, me përvojë në auditim, raportim financiar dhe trajnime profesionale si lektore, ndjej një përgjegjësi të veçantë për të kontribuar në forcimin e profesionit dhe mbrojtjen e integritetit që përfaqëson IEKA.

Jam diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, në degën Kontabilitet, dhe kam përfunduar studimet Master në Universitetin Erasmus Hollandë në fushën e Kontabilitetit, Auditimit dhe Kontrollit. Kam punuar për 7 vite në një nga kompanitë Big 4 në Shqipëri.

Jam anëtare e ACCA nga viti 2019. Gjithashtu jam certifikuar për IPSAS nga ACCA dhe aktualisht jam e angazhuar në zhvillimin e kuadrit të ri rregullator të raportimit financiar për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS).

Jam lektore pranë IEKA-s, në fushën e raportimit financiar të avancuar (IFRS), duke kontribuar në edukimin dhe licencimin e brezave të rinj të audituesve, lektore në programet e zhvillimit profesional të vazhdueshëm (CPD) për audituesit ligjorë si edhe lektore pranë IKM-së për standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Aplikimin për Këshillin Drejtues të IEKA-s e bëj me dëshirën dhe vullnetin e mirë për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të Institutit, me synimin që IEKA të jetë një institucion elitar, si për nga cilësia e shërbimeve profesionale që ofrojnë anëtarët e saj, ashtu edhe për nga impakti dhe bashkëpunimi me institucionet vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë Bankën Botërore dhe organet ligjvënëse, me qëllim që profesioni ynë të ketë një zë të fortë dhe të dëgjueshëm në zhvillimin e politikave ekonomike e financiare në vend.

Nëse zgjidhem anëtare e Këshillit, synoj të sjell një kontribut aktiv dhe të matshëm në disa fusha kyçe:

1. Fryma e Gjithëpërfshirjes dhe Transparencës në Drejtimin e IEKA-s

Në vizionin tim, IEKA duhet të funksionojë me frymën e një organizate ku çdo anëtar është “aksionar” i vërtetë në zhvillimin dhe drejtimin e institutit. Si një organizatë jofitimprurëse që financohet kryesisht nga kuotat e anëtarësisë, IEKA ka detyrimin të garantojë transparencë të plotë në vendimmarrje dhe të ofrojë mundësi reale për përfshirjen aktive të anëtarëve në komitetet, grupet e punës dhe politikat strategjike të institutit. Anëtarët duhet të kenë të drejta konkrete për të marrë informacion të rregullt mbi përdorimin e fondeve, për të propozuar nisma dhe politika, për të kandiduar në komitetet drejtuese, si dhe për të marrë



si

pjesë në proceset e konsultimit për rregullore, programe trajnimi dhe standarde profesionale. Ky model gjithëpërfshirës rrit ndjenjën e përgjegjësisë kolektive, fuqizon zërin e çdo profesionisti dhe siguron që vendimmarrja të pasqyrojë interesat e gjerë të anëtarësisë dhe jo vetëm të strukturave drejtuese.

Do të stimulohen dhe do të organizohen edhe aktivitetet me karakter social kulturor, gjithë grupi ose grupe të vogla, bazuar në kërkesat e antarësisë me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe komunikimit midis kolegëve.

2. Forcimi i rëndësisë dhe cilësisë së profesionit

Rritja e cilësisë së shërbimeve të auditimit dhe raportimit financiar është themeli mbi të cilin ndërtohet besueshmëria e profesionit tonë. Për të arritur këtë objektiv, një nga prioritetet kryesore duhet të jetë forcimi i rolit, kapaciteteve dhe autoritetit të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë pranë IEKA-s. Ky komitet duhet të shërbejë jo vetëm si një organ mbikëqyrës, por edhe si një mekanizëm edukues dhe udhëzues për anëtarët.

Rritja e transparencës dhe qartësisë së kërkesave

Anëtarët e IEKA-s duhet të kenë udhëzime të qarta, të detajuara dhe lehtësisht të zbatueshme mbi kërkesat e kontrollit të cilësisë, si në nivel firmash ashtu edhe në nivel angazhimesh individuale. Publikimi i manualeve të përditësuara, udhërrëfyesve praktikë dhe modeleve të dokumentimit do t'i ndihmonte firmat dhe audituesët të kuptojnë më mirë pritshmëritë, duke reduktuar paqartësitë dhe duke rritur nivelin e përputhshmërisë. Përveç inspektimeve periodike, Komiteti duhet të ofrojë sesione informuese dhe trajnime praktike, në mënyrë që anëtarët të ndihen të mbështetur dhe të përgatitur për të zbatuar kërkesat.

Harmonizimi me kërkesat e BMP-së

Qëllimi do të jetë harmonizimi i standardeve dhe metodologjive të kontrollit midis IEKA-s dhe BMP-së, përmes një dialogu të strukturuar dhe bashkëpunimi institucional. Kjo nismë do të siguronte që proceset e kontrollit të cilësisë të jenë të njëjta, të qarta dhe të njohura për të gjithë anëtarët, duke ruajtur standardet më të larta ndërkombëtare por pa krijuar barrë administrative shtesë.

Ndikimi tek anëtarët dhe profesioni

Forcimi i Komitetit të Kontrollit të Cilësisë, qartësimi i kërkesave dhe harmonizimi me BMP-në do të sjellë rritje të cilësisë së auditimeve, besueshmëri më të lartë të pasqyrave financiare, dhe do të forcojë perceptimin publik për profesionin. Në këtë mënyrë, anëtarët do të kenë jo vetëm mbikëqyrje, por edhe mbështetje praktike për të ruajtur integritetin profesional dhe për të përmbushur me sukses detyrimet ligjore dhe etike.

3. Edukim i vazhdueshëm profesional dhe zhvillim i anëtarëve

Do të angazhohem për përmirësimin e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve dhe zgjerimin e programeve të trajnimit dhe certifikimit, duke përfshirë temat më aktuale në fushën e raportimit financiar, auditimit, teknologjisë dhe raportimit të qëndrueshmërisë. Qëllimi im është që çdo anëtar të ketë akses në njohuritë më të fundit për të ruajtur dhe rritur konkurrueshmërinë profesionale. Bashkëpunimi me organizata profesionale ndërkombëtare për marrjen e përvojave më të mira lidhur me trajnimet profesionale për anëtarët dhe kyzerjen e auditimeve në përputhje me kërkesat e SNA. Përfshirja e trajnuesve nga organizatat simotra të huaja ose nga programet e Bankës Botërore.

4. Rritja e Bashkëpunimit Kombëtar dhe Ndërkombëtar

Do të punoj për të përmirësuar marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe të partneritetit institucional me Ministrinë e Financave, me Kontrollin e Lartë të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Universitetet, Bankën Botërore, BERZH, IKM, KKK ose organizmat e tjera profesionale me qëllim që Instituti të jetë i pranishëm dhe kontributor në të gjitha çështjet ku profesioni dhe anëtarësia e tij është palë e interesuar ndikuese ose e ndikuar. Bashkëpunimi me organizata profesionale ndërkombëtare për marrjen e përvojave më të mira.

5. Mbështetja e brezit të ri të profesionistëve

Forcimi i rolit të anëtarëve më të rinj të IEKA-s është thelbësor për vazhdimësinë dhe gjallërinë e institutit. Si anëtare e Këshillit të Drejtimit synoj të krijoj politika që fuqizojnë profesionistët e sapolicencuar dhe ata me pak vite eksperiencë, duke u dhënë mundësi të marrin pjesë aktivisht në jetën institucionale dhe të kontribuojnë në vendimmarrje.

Qëllimi është që këta anëtarë të mos mbeten vetëm përfitues pasivë të shërbimeve, por të përfshihen në komitetet ekzistuese – si komitetet të edukimit të vazhdueshëm, të etikës dhe kontrollit të cilësisë – ku mund të japin ide të reja dhe të sjellin perspektivën e gjeneratës së tyre. Përfshirja në këto struktura do t'i ndihmojë anëtarët e rinj të zhvillojnë kompetencat profesionale, të ndërtojnë rrjetin e tyre, si dhe të kuptojnë më mirë proceset e qeverisjes së institutit.

Këto masa do të shoqërohen me mekanizma transparentë aplikimi dhe përzgjedhjeje, mentorim nga profesionistë me eksperiencë dhe vlerësim periodik të kontributit të tyre. Kështu, anëtarët më të rinj do të ndihen të vlerësuar dhe të përfshirë, ndërsa IEKA do të përfitojë nga energjia, idetë dhe vizioni i një brezi që do të mbajë mbi supe zhvillimin e profesionit në vitet në vijim.

6. Përshtatja me transformimin digjital

Do të propozoj zhvillimin e software auditimi për të lehtësuar punën e audituesve dhe për të rritur efikasitetin e shërbimeve që ofron profesioni. Synimi kryesor është zhvillimi i një formati standard të automatizuar të procedurave dhe të dosjes së auditimit.

Angazhimi Personal dhe Vlerat

Besoj se integriteti, pavarësia dhe profesionalizmi janë themeli i profesionit tonë. Në punën time të përditshme, kam treguar përkushtim ndaj **etikës profesionale**, cilësisë së lartë të shërbimit dhe edukimit të brezit të ardhshëm të audituesëve. Anëtarësimi në Këshillin e Drejtimit përfaqëson për mua jo vetëm një përgjegjësi, por edhe një mundësi për të ndikuar në rritjen e besueshmërisë së profesionit, forcimin e rolit të IEKA-s në shoqëri dhe për të përkrahur zhvillimin e vazhdueshëm të anëtarëve të tij.

Ju falenderoj për vlerësimin e kandidaturës sime dhe mbështetjen tuaj.

Me respekt,

Iris Qirjaqi

Auditues Ligjor

Licenca nr. 350, datë 16.01.2015